

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORTI I MISIONIT

2.3.1.3 Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare me fokus të veçantë në Llogaritë Kombëtare Tremujore

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga Clementina Ivan-Ungureanu,

Statistikat e Danimarkës

1-5 Dhjetor 2014

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	6
2. Vlerësimi dhe rezultatet	6
2.1 BPVT 2010-2013	6
2.2 BPVT për tremujorin e parë të vitit 2014.....	8
2.3 Tranzicioni në NACE rev.2.....	9
2.4 Konferenca për shtyp	9
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	9
Aneksi 1: Termat e Referencës	11
Aneksi 2. Personat e takuar	15

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BoP	Bilanci i Pagesave
BEC	Kategorië e Mëdha Ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
KKF	Konsumi i Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GFCF	Formimi i Bruto Kapitalit Fiks
GFC	Konsumi Final i Qeverisë
HFC	Konsumi Final i Ekonomisë Familjare
IC	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informativë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MoU	Memorandum i Mirëkuptimit

LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NPISH	Institucionet Jo-Profitable në Shërbim të Ekonomive Familjare
NOE	Ekonomia e Pavrojtuar
OJQ	Organizata joqeveritare
IÇP	Indeksi i Çmimit të Prodhimit
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afat Shkurta
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje ekzekutive

Misioni aktual në komponentin 2 – *Llogaritë Kombëtare* të projektit të binjakëzimit si objektiv kryesor kishte analizimin e vlerësimeve të BPV-së tremujore (BPVT) sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante, për vitet 2010-2013, për të përkrahur ASK-në në vlerësimet e BPVT-së së tremujorit të parë të vitit 2014 dhe për përgatitjen e publikimit të parë në këtë fushë.

Gjatë këtij viti, ASK ka implementuar BPV-në tremujore (BPVT) sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve në kornizën e projektit të IPA 2011. Seritë kohore janë zhvilluar për vitet 2010-2013, duke u bazuar në të dhënat vjetore dhe burimet e të dhënave statistikore dhe administrative që ishin në dispozicion. Vlerësimi i BPVT-së për tremujorin e parë të vitit 2014 është bazuar në metodologjinë e zhvilluar gjatë projektit.

Gjatë misionit aktual, vlerësimet për BPVT-në e viteve 2010-2013 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante, janë analizuar dhe finalizuar, me vëmendje të veçantë në balansimin e këtyre dy qasjeve. Vlerësimi i tremujorit të parë të vitit 2014 është realizuar duke u bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion, që përfshin qarkullimin e ndërmarrjeve të siguruar nga Administrata Tatimore, pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendrore, bankat e tjera komerciale dhe kompanitë e sigurimeve) dhe të dhënat statistikore mujore dhe tremujore (çmimet si IÇP, IÇK dhe çmimet e bujqësisë). Cilësia e vlerësimeve tremujore të BPV-së varet nga burimet e të dhënave që janë në dispozicion dhe besueshmëria e tyre. Në Kosovë ka një mungesë e madhe të burimeve statistikore në baza tremujore, përfshirë informata në lidhje me bujqësinë, industrinë përpunuese, ndërtimtarinë, shërbimet dhe prodhimin. Aktualisht të vetmet të dhëna mbi qarkullimin, që mund të përdoren, janë të dhënat që ofrohen nga Administrata Tatimore, për vlerësimet tremujore të indikatorëve të njësive jo-financiare. Për këtë arsye, rekomandohet fuqishëm që ASK të bëjë më shumë përpjekje në të ardhmen e afërt për përmirësimin e statistikave afat shkurta (STS).

Publikimi i parë i BPVT-së është përgatitur gjatë këtij misioni; të dhënat janë publikuar me 5 Dhjetor të vitit 2014. ASK do të vazhdojë me publikimet në baza të rregullta, planifikohet që vlerësimet tremujore të vitit 2014 të publikohen në tremujorët e radhës të vitit 2014 deri në Qershor të vitit 2015. Këto të dhëna do të konsiderohen si të përkohshme; vlerësimet vjetore të BPV-së do të rishikohen dhe përmirësohen dhe kjo do të ketë ndikim në të dhënat tremujore.

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'.

Objektivat e misionit kanë qenë të përkrahjet ASK në vlerësimin e BPVT-së të vitit 2010 – tremujori i parë i vitit 2014 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante dhe për përgatitjen e publikimit të parë në këtë fushë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e praqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve tjerë (NI-C)/Statistikat e Finlandës/Istat/ Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 BPVT 2010-2013

Vlerësimet e BPVT-së kanë filluar në kornizën e projektit IPA 2011 (periudhën Shtator 2012-Mars 2014). Për krijimin e metodologjisë së vlerësimit të BPVT-së, janë zhvilluar këto aktivitete:

- Analizimi dhe grumbullimi i burimeve të të dhënave statistikore dhe administrative, në baza tremujore, për vitet 2010-2013, vite për të cilat BPV-ja vjetore është në dispozicion sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve;
- Vlerësimet e BPVT-së për këtë periudhë, me çmime aktuale dhe konstante, bazuar në burimet në dispozicion dhe analizimin e mospërputhjeve në mes rezultateve të marra dhe vlerësimeve vjetore;
- Balancimi i BPVT-së me të dhënat vjetore dhe përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit.

Burimet e të dhënave statistikore dhe administrative që janë në dispozicion në baza tremujore, janë rishikuar gjatë misionit. Në sistemin statistikor, ka disa burime në dispozicion:

- Statistikat tremujore të hoteleve (numri i turistëve, netët e kaluara) me të dhëna që fillojnë nga viti 2009;
- AFP Tremujore, duke filluar nga vitit 2012;
- Indikatorët e transportit tremujor si pasagjerët-km dhe ton-km;
- Të dhënat statistikore në lidhje me çmimet (Indeksi i Çmimeve të prodhimit (IÇP), Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK), Indeksi i Çmimit të Importit (IÇIM) dhe çmimet e bujqësisë (për outputet dhe inputet).

Burimet administrative janë:

- Të dhënat nga Administrata Tatimore në lidhje me qarkullimin dhe blerjet e ndërmarrjeve (blerjet e konsumit të ndërmjetëm dhe blerjet e investimeve);

- Të dhënat administrative nga kompanitë e mëdha me aktivitet në prodhimin dhe distribuimin e energjisë, aktivitetit të postës dhe transportit ajror;
- Pasqyrat financiare të bankave dhe kompanive të sigurimit;
- Të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë.
- Fillimi i aktivitetit për implementimin e BPVT-së ka qenë ndarja në 'tremujorë' i të dhënave vjetore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve dhe krijimi e serive kohore afat shkurta, të shfrytëzueshme për definimin e metodologjisë së vlerësimeve.

Vlerësimi i Vlerës së Shtuar bruto (GVA) i njësive jo-financiare për periudhën 2010-2013 sa i përket qarkullimit, është bazuar kryesisht në të dhënat prej Administratës Tatimore. Në vlerësimet tremujore është aplikuar përqindja e konsumit të ndërmjetëm në output, sipas aktivitetit, nga vlerësimet vjetore. Outputi dhe konsumi i ndërmjetëm i njësive financiare dhe i qeverisë janë vlerësuar drejtpërdrejt bazuar në të dhënat e ofruara nga Banka Qendrore e Kosovës dhe nga Ministria e Financave. Për shkak të burimeve të mangëta të të dhënave, disa aktivitete të BPV sipas qasjes së prodhimit janë shpërndarë në mënyrë lineare nëpër tremujorë; ka raste të sigurimeve, qerasë së përllogaritur dhe shërbimeve të ofruara nga institucionet jo-profitabile, që i shërbejnë ekonomive familjare (NPISH).

Një problem i rëndësishëm, për shkak të mungesës së të dhënave, është vlerësimi i indikatorëve të bujqësisë. Në ASK dhe në Ministrinë e Bujqësisë nuk ka të dhëna në baza tremujore. Shpërndarja e outputit dhe konsumit të ndërmjetëm sipas tremujorëve është bazuar në informata nga llogaritë kombëtare të Maqedonisë dhe Shqipërisë, duke pasur si supozim kryesor që aktiviteti i bujqësisë në Kosovë është i ngjashëm me ato në dy vendet fqinje.

Disa komponente të BPVT-së 2010-2013 sipas qasjes së shpenzimit është vlerësuar në mënyrë direkte duke përcjellur metodologjinë e njëjtë si për atë vjetore; siç është rasti i GFCF-së, Konsumit final të qeverisë, importeve dhe eksporteve të mallrave dhe shërbimeve. Konsumi final i NPISH-së është alokuar sipas tremujoreve në të njëjtën mënyrë si outputi përkatës. Për shkak të mungesës së të dhënave tremujore, që janë të nevojshme për vlerësimin e konsumit final të ekonomive familjare, është zhvilluar metoda e rrjedhës së mallit dhe është aplikuar për kalkulime.

Çmimet konstante janë vlerësuar duke përdorur çmimin mesatar të vitit paraprak. IÇP, IÇK dhe IÇIM korresponduese janë përdorur për kalkulime.

Gjatë misionit është zhvilluar një aktivitet intenziv për të balancuar çdo BPVT për periudhën 2010-2013 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante. Është vërejtur që dallimet e dy qasjeve kanë qenë të vogla në çmimet aktuale (sidomos për vitin 2013) por mjaft sinjifikante në çmime konstate. Janë analizuar dhe eliminuar këto dallime në bazë të evoluimit të indikatorëve.

2.2 BPVT për tremujorin e parë të vitit 2014

BPVT për tremujorin e parë të vitit 2014 është vlerësuar bazuar në burimet në dispozicion dhe metodologjinë e zhvilluar.

- Indikatorët e bujqësisë janë vlerësuar bazuar në të dhënat e tremujorit korrespondues të vitit paraprak dhe çmimeve të outputit të bujqësisë, duke supozuar që volumi ka qenë konstant.
- Outputi tremujor me çmime aktuale të sektoreve të Minierave, Prodhimit dhe Shërbimeve, është vlerësuar në bazë të qarkullimit. Shkalla e rritjes tremujore është aplikuar në outputin e tremujorit të parë të vitit 2013, në nivelin 2 shifror të NACE rev.1. Kur janë fituar rezultatet të pambështetura, outputi është vlerësuar bazuar në IÇP-në përkatëse, duke supozuar që shkalla e rritjes reale është 100%. Konsumi i ndërmjetëm është vlerësuar duke përdorur të njetën shkallë të I/O si tremujor përkatës të vitit paraprak.
- Outputi i ndërtimtarisë është vlerësuar duke përcjellë vlerësimet vjetore, bazuar në metodën e inputit.
- Aktiviteti financiar është vlerësuar drejtpërdrejt bazuar në të dhënat mujore të ofruara nga Banka Qendore, duke përcjellë të njetën metodologji si në kalkulimet vjetore. Vlerat konstante janë vlerësuar duke përdorur IÇK-në korresponduese. FISIM është kalkuluar duke përcjellë metodologjinë vjetore dhe është alokuar te përdoruesit.
- Outputi i qeverisë është vlerësuar në bazë të qasjes së kostos, duke përdorur informata të detajuara nga Ministria e Financave.
- Për shkak të mungesës së informatave në lidhje me NPISH-në, outputi është vlerësuar në bazë të IÇK-së korresponduese dhe duke marrë në konsideratë shkallën reale të rritjes në nivel të njetë me vitin paraprak.

BPVT sipas qasjeve të shpenzimeve është vlerësuar si në vijim:

- Konsumi Final i Ekonomive Familjare (HFC) është vlerësuar bazuar në qasjen e rrjedhës së mallit, për shkak të mungesës të dhënave tremujore. Prej SUT të viti 2007, përqindja e HFC-së është kalkuluar në prodhimin total dhe është aplikuar në të dhënat tremujore të prodhimit. Kalkulimet janë bërë për këto kategori të mëdha të konsumit: Konsumi i mallrave prej aktivitetit të tregëtisë; Konsumi i mallrave bujqësore nga prodhimi vetanak; Hotelet dhe restaurantet; Transporti; Shërbimet financiare (përfshirë FISIM dhe sigurimet) dhe shërbimet e tjera (shëndetësia, edukimi dhe shërbimet e tjera për popullsinë). Vlerësimi i çmimeve konstante për HFCE-në është bazuar në deflacion, duke përdorur IÇK-në korresponduese.
- Elementet tjera të BPV-së (Konsumi Final i Qeverisë, GFCF, importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve) janë vlerësuar drejtpërdrejt, duke përdorur metodën e njetë si në kalkulimet vjetore.

- Ndryshimet në inventar së pari janë vlerësuar në të njejtin nivel si tremujori përkatës i vitit paraparak dhe janë përshtatur në procedurën e balancimit.

Mosbalanci në të dy qasjet nuk ka qenë i madh, më pak se 2%; përshtatjet janë bërë kryesisht për qasjen e shpenzimeve, në HFC dhe ndryshimet në inventar.

2.3 Kalimi në NACE rev.2

Kalkulimet për BPVT kanë filluar një vit më parë, bazuar në NACE rev.1. ASK ka implementuar klasifikimin e ri NACE rev.2, pas Shtatorit të vitit 2014. Në fund të Nëntorit të këtij viti, ASK ka publikuar BPV-në sipas qasjes së prodhimit, bazuar në NACE rev.2. për periudhën 2008-2013. Në këto rrethana, të gjitha kalkulimet e të dhënave tremujore bazuar në NACE rev 1 janë rishikuar dhe përkthyer në NACE rev 2. Tabelat e njejta të përkthyer (shih raportin e misionit nga data 25-28 Gusht të vitit 2014) që janë përdorur për të dhënat vjetore, janë aplikuar për vlerësimet tremujore.

2.4 Konferenca për shtyp

Konferenca e parë për shtyp sa i përket BPVT-së është realizuar gjatë misionit. Janë analizuar çështjet metodologjike në mënyrë që t'u shpjegohen përdoruesve burimet kryesore të të dhënave dhe metodat e përdorura. Detajet e prezantimit të të dhënave janë vendosur së bashku me stafin dhe menaxhmentin e Llogarive Kombëtare, duke marrë për bazë përvojat e vendeve fqinje.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Implementimi i BPVT-së është shumë i rëndësishëm dhe një vendim i mirëpritur i ASK. Është bërë punë e madhe për të arritur këtë objektiv. Të dhënat e publikuara paraqesin vlerësimet e para të BPVT-së dhe përmirësimet e mëtejme, që janë të nevojshme.

Rekomandohet fuqishëm të përmirësohet vlerësimi i indikatorëve të bujqësisë. Është më se e nevojshme të investigohen burimet e tjera administrative në këtë fushë, si për shembull Agjencioni i Veterinarisë (për të marrë disa informata në lidhje me numrin e kafshëve) ose disa asociacione profesionale (si procesimi i qumështit).

Pika e dobët e vlerësimeve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve është ndryshimi në inventar; ky problem nuk është vetëm për tremujorët, por edhe për të dhënat vjetore. Është e nevojshme të zhvillohet një metodologji për vlerësimin e ndryshimit në inventar, bazuar në analizimin e burimeve ekzistuese.

Vlerësimi i indikatorëve tremujorë të njësive jo-financiare është i bazuar pothuajse në tërësi (përveç prodhimit të energjisë elektrike) në të dhënat mbi qarkullimin. Analizimi i të dhënave për tremujorët e parë të vitit 2013 dhe 2014 ka nxjerrë në pah mospërputhje për disa aktivitete. Për shembull, në aktivitetin 26 "Prodhimi i produkteve tjera minerale jo-metalike", qarkullimi në tremujorin e parë të vitit 2014 është dyfish në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2013 (22.6 milion euro dhe 44.6 milion euro në vitin 2014); dhe shembujt mund të vazhdojnë për 15 aktivitete të tjera. Për këtë arsye, rekomandohet fuqishëm të zhvillohet një procedurë për analizimin më të thellë të evoluimit të ndërmarrjeve të mëdha (sipas kodit

NACE, së paku në nivel dy shifror) që sigurojnë më shumë se 75% të qarkullimit total. Në këtë mënyrë, mund të identifikohen dhe shpjegohen mospërputhjet e qarkullimit nga një tremujor në tjetrin (nëse ka në të vërtetë) ose të eliminohen (nëse janë për shkak të klasifikimit të gabuar të njësive).

Për momentin, bazuar në Protokolin e nënshkruar me Administratën Tatimore, ASK pranon në baza të rregullta, të dhëna individuale për ndërmarrjet. Por, këto të dhëna grumbullohen dhe procesohen vetëm nga një person, që i takon departamentit Ekonomik. Rekomandohet që stafi i Departamentit të LLogarive Kombëtare të ketë qasje direkte në të dhënat e Administratës Tatimore dhe t'i përdorin ato sipas nevojave të tyre.

Aneksi 1: Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.3.1.3: Përkrahje për implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare me fokus të veçantë në Llogaritë Kombëtare Tremujore

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 20 Nëntor 2014

Fillimi / fundi i aktivitetit: 1-5 Dhjetor 2014

Koha e raportimit: 12 Dhjetor 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.3	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare me fokus special në Llogaritë Kombëtare Tremujore	- Raporti i misionit i publikuar në faqen e internetit - Harta rrugore e detajuar për implementimin e planit të veprimit me fokus të veçantë në Llogaritë Kombëtare Tremujore - Afati kohor për implementimin e Llogarive	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Staafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në

		Kombëtare Tremujore, i përcaktuar dhe diskutuar		statistikat primare të sakta • Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 2.3.1.3

Konsultimet dhe diskutimet me njësinë e Llogarive Kombëtare.

Harta rrugore e Llogarive Kombëtare, e paraqitur në tabelën 2 në raportin e misionit nga aktiviteti 2.1.1 (Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të Veprimt), i udhëhequr nga Graversen dhe Ungureanu, specifikon hapat e nevojshëm (2.1 deri 2.7) për kompletimin e publikimit në baza të rregullta të llogarive kombëtare në baza tremujore. Ky aktivitet është një prej aktiviteteve të para, i dizajnuar për përcaktimin e hapave në azhurnimin e planit veprues.

Implementimi i llogarive kombëtare në baza tremujore gjatë vitit 2014 është një aktivitet mjaft ambicioz. Për këtë arsye ky aktivitet duhet të përkrahë stafin e ASK-së që të bëjë një detajizim të saktë të hapave, që duhen të ndërmerren dhe një vlerësim të resurseve dhe prioritetizimet e nevojshme.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.3.1.3:

Raporti i misionit. Analizimi i vlerësimit të BPVT-së për periudhën 2010-2012 dhe rekomandimet për publikimin e Llogarive Kombëtare Tremujore.

Trajnimi në praktikë për publikimin e BPVT-së

Stafi i ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapit, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapit@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Eksperte, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK me mbështetjen e IPA ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaroi që ASK-ja inkurajohet të prodhojë vlerësime fillestare për BPV-në në baza tremujore, me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve. Departamenti i Llogarive Kombëtare duhet të sigurohen të dhëna të cilësisë së lartë nga fusha të ndryshme statistikore, sidomos nga statistikatat e biznesit.

Raporti i misionit të Binjakëzimit mbi Vlerësimin dhe Azhurnimin e Planit të Veprimit (Ivan-Ungureanu dhe Graversen, Statistikat e Danimarkës) thekson që ASK-ja zhvillon një aktivitet intensiv për implementimin e llogarive kombëtare në baza tremujore. Aktiviteti ka filluar në fillim të vitit 2013, në kornizën e programit multi-përfitues IPA 2011. Implementimi i procesit ka filluar me vlerësimin e BPVT me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve për vitet 2010-2012, për të cilat ka pasur të dhëna në dispozicion. Analizimi i rezultateve do të përdoret për të definuar metodologjinë e vlerësimit të BPVT në kohë reale, bazuar në burimet e të dhënave që janë në dispozicion.

Ky mision në kuadër të Projektit të Binjakëzimit në ASK mbështet këtë punë me një aktivitet për finalizimin e vlerësimeve për vitet 2010-2013 dhe tremujorin e parë të llogarive kombëtare të vitit 2014 dhe publikimin e të dhënave në fund të vitit 2014.

Aktivitet, që duhen të ndërmerren:

- Analizimi i BPVT-së për periudhën 2010-2012 me çmime aktuale dhe konstante
- Përkrahja e ASK-së në finalizimin e vlerësimeve për vitin 2013

- Përkrahja e ASK-së në përgatitjen e publikimit të parë për BPV tremujore

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit të raportimit
 - BPVT për periudhën 2010-2013 në çmime aktuale dhe konstante e gatshme për publikim
- Rekomandimet për aktivitetet në vijim për implementimin e procesit në lidhje me BPVT.

Aneksi 1. Programi, - Dhjetor 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00	Plani javor
		09:30	Vlerësimi i BPVT për periudhën 2010-2012, në çmime aktuale dhe konstante
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Vlerësimi i BPVT për periudhën 2010-2012, në çmime aktuale dhe konstante – vazhdim
		12:00	Dreka
		13:15	Vlerësimi i BPVT për periudhën 2010-2012, në çmime aktuale dhe konstante – vazhdim
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Vlerësimi i BPVT për periudhën 2010-2012, në çmime aktuale dhe konstante – vazhdim
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00	Vlerësimet e BPVT-së 2013, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante
3	ASK	09:00	Vlerësimet e BPVT-së 2014, tremujori i parë, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante
4	ASK	09:00	Përgatitja e publikimit të vlerësimeve të BPVT-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve për periudhën 2010-2013 dhe Tremujorin e parë të vitit 2014 në çmime aktuale dhe konstante
5	ASK	09:00	Përgatitja e publikimit të vlerësimeve të BPVT-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve për periudhën 2010-2013 dhe Tremujorin e parë të vitit 2014 në çmime aktuale dhe konstante

		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Rekomandimet për aktivitetet në vijim
		12:00	Dreka
		13:15	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare,
Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare,
Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, Asistente e RTA